

Procesverbal

*Nga mbledhja e III-të - e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë:
07.02.2023*

Rend Dite

- 1) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e III-të,
- 2) Eventuale...

Uran Halimi: Pershendetje të nderuar, miresekenia rdh në mbledhjen e 3 të rregullt të vitit 2023 të KPF, e kemi shqyrtimin e materialit të Kuvendit për seancën e III-të, sa i përket procesverbaleve ato janë në përpunim e sipër me qenë se sic e dini edhe ju ka pas kogja amterial me e bo gati, e hedhim në votim rendin e ditës, 6 pro 0 kundër dhe 0 abstenim, vazhdojmë me materialin që e kemi për seancën e nesërme, 1. Plani i Punës (Vazhdimi i pikës së IV-të nga seanca e kaluar), 2. Raporti Vjetor Financiar 01 Janar deri 31 Dhjetor 2022, 3.Miratimi i Rregullores për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe 4.Eventuale.

Nese do me marr fjalën dikush?.. sa i përket Planit të Punës...

A do me marr fjalën dikush për pikën e II-të,?... Raporti Vjetor Financiar 01 Janar deri 31 Dhjetor 2022,

A do me marr fjalën dikush për pikën e III-të,?...Miratimi i Rregullores për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Sa i përket pikes eventuale a dëshiron dikush me e marr fjalën?... nëse ska atëherë vazhdojmë i kemi disa kërkesa për KPF ku njëra ndër të është kërkesa nga QPS që i është drejtuar KPF ka të bëjë me familjen strehuese që ka të bëjë për përkrahje materiale të familjes strehuese Agim dhe Selvinaz Skeraj, e citoj kërkesën ‘‘I nderuar Kryetar dhe ju anëtar të KPF-së bazuar në nevojën dhe obligimin ligjor që ka Qendra për Punës Sociale dhe Komuns që sipas standardeve minimale të kemi 3 (tri) Familje Strehuese, QPS në Dragash Sektori I Sherbimeve Sociale Profesionale ja ka arritur në fillim të vitit 2014 të rekrutoj, vlerësoj dhe ta trajnoj një Familje Strehuese, bashkëshortët Agim dhe Selvinas Skeraj nga f.sh. Rrenc Komuna e Dragashit. Familja Strehuese ka treguar qellimin humanitar dhe është shumë e përkushtuar në Strehimin dhe përkujdesjen e fëmijëve që kan mbetur për arsye të ndryshme pa përkujdesje prindërore dhe familjare: fëmijët e abuzuar, fëmijët e keqtrajtuar dhe fëmijët që janë neglizhuar të lënë pas dore nga prindërit

biologjik..... Kërkojë nga ju që të na përkrahni në rautëjen, në kos largimin e kësaj Familje Strehuese me një shumë materiale prej 1200€ që i bjen 100€ në muaj që familja ta ket përkrahjen dhe mbeshtetjen nga komuna’’, d.m.th ka kërkuar 100 Euro në muaj e në total 1200 Euro për vitin 2023.

Bexhet Xheladini: I nderuar Kryesues zv.Kryesues Anëtar të KPF-së, përfaqësues të OSCE-së etj. Sa i përket kërkesës së Agim Skeraj e cila është e vetmja familje strehuese në Komunën tonë, lidhur me këtë çështje unë para disa ditëve kam pasur një takim me përfaqësuesit e organiztës për fëmijët pa përkujdesje prindërore, znj. Ibadete Krasniqi me delegacionin e saj, dhe pas një debati të gjerë ku pjesmarrës kanë qenë edhe disa asambleistë, dhe jemi marr vesh që kësaj familje të i ndihmojmë me një shumë më të madhe se sa në vitin e kaluar, dhe mendimi im është që ta mbeshtetni këtë familje ashtu siç e ka bërë kërkesën.

Uran Halimi: A dëshiron dikush tjetër ta marr fjalën?... nëse jo e hedhim në votim.

Kush është pro që me i ndihmue kësaj familje? 7 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim.

Vazhdojmë me kërkesën tjetër, ku ka të bëjë me ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve për udhëtim për në shkollë speciale sipas kërkesës ‘‘ Lexohet kërkesa’’..... ky prind kërkon mbulimin e shpenzimeve të rrugës, për dërgimin e fëmijut të tij për shkollë speciale, rreth kësaj kërkesë me sa e di unë duhet ta mbulojë drejtoria e arsimit, kryetari e ka kërkuar fjalën....

Bexhet Xheladini: Ne këtij rasti i kemi ndihmuar edhe vitin e kaluar, e di edhe shumë që duhet të i ndihmohet ne do të i ndihmojmë prap, duke e marr parasyshtë se Drejtoria e Arsimit këtë vit nuk ka mjete nga subvencionet sepse vitin e kaluar subvencionet janë marrë nga Qeveria të hyrat vetanake, mirëpo këtë kërkesë do ta mbulojmë nga subvencionet e zyrës së Kryetarit dhe sipas mundësive si pasoj e ngritjes së çmimeve shuma do të jetë më e lartë.

Artan Loshaj: Pershendetje për të gjithë, desha vetëm ta bëjë një pyetje, a është shuma mbi 1.000 Euro a jo? Unë e di at fëmij, aj nuk sheh hiç, e di që e ki vullnetin me i ndihmue mirëpo nëse është mbi 1.000 Euro, dhe besojë se ky fëmijë duhet me u mbeshtet në maksimum.

Uran Halimi: Nese mendoni se duhet të i ndihmojë ne si Komitet e qesim në votim propozimin, kush është pro që komiteti me i ndihmue në vlerën e kërkuar 1170 Euro në vit?... ok atëher po ja

bartim Kryetarit me 990 Euro, pra kush është pro me i ndihmue kësaj familje me 990 Euro, 7 pro 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kemi edhe një kërkesë nga Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega në Dragash “ Ku në kërkesë thot se Kryqi i Kuq vepron në bazë të 7 parimeve (humaniteti, paanësia, neutraliteti, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe univerzaliteti).... citohet e tërë kërkesa.....” kërkon nga KPF që të mbeshtetet me 2.190.00€.

Bexhet Xheladini: Unë kam vendos që Kryqit të Kuq, Organizatës së Pensinistëve dhe OVL-UÇK-s të i mbeshtes me shumën maksimale timen të lejueshme të gjithve në mënyrë të barabartë.

Uran Halimi: Kryetar po mendon që edhe këtë kërkesë të bartet tek ju?... Kush do me marr fjalën dikush tjetër?... e hedhim në votim kush është pro që kjo kërkesë të i kalojë Kryetarit.

7 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim, faleminderit edhe kjo kërkesë i bartet Kryetarit

E kemi edhe një kërkesë ku e ka bërë për Kryetarin e Komunës së Dragashit, Drejtorinë e Urbanizmit dhe e ka përfshirë Kuvendin Komunal, pra bëhet fjalë për MoEnja Sh.P.K. ku ka të bëjë me marrjen në shfrytëzim të pronës Komunale (citohet kërkesa në tërësi), pra ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale, këtë kërkesë me qenë se ja ka bërë Drejtorisë për Urbanizëm atëher le të i vazhdoj procedurat, dhe në momentin që Drejtoria e Urbanizmit na sjell në Kuvend ne diskutojmë dhe i Shqyrtojmë se cilat janë më të mirat e mundshme, ne sjemi kundër bizneseve e sidomos kërkesës për prodhim të energjisë solare ku dihet se është me e favorshmja dhe më e përshtatshme koheve të fundit, andaj këtë kërkesë e lexova vetëm që të ju njoftoj sepse ne skemi çka votojmë këtu, mirëpo nese i sjell procedurat e duhura dhe na sjell Drejtoria e Urbanizmit ne e shqyrtojmë.

Nëse do me marr fjalën dikush për këtë kërkesë?... nëse jo atëherë e shpalli këtë mbledhje të mbyllur, faleminderit shumë.

Kryesuesi i KPF-së: Uran Halimi
